



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 29-09-2025
Nr. 5/3588

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesa nr. 5-3581 e datës 24.09.2025 e parashtruar nga Kolegji Universum, nxjerr:

V E N D I M
Për licencimin e Kolegjit Universum

1. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji Universum kampusi kryesorë në Prishtinë, licencohet për periudhën trevjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), sipas vendimit të AKA/s me nr. 588/25, datë 27.05.2025, për programin e studimeve.
 - 1.1. Psikologji, BSc, 180 ECTS, me kuotë 100 studentë për vit akademik.
2. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji Universum kampusi kryesorë, rilicencohet për periudhën trevjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), sipas vendimit të AKA/s me nr. 588/25, datë 27.05.2025, për programin e studimeve;
 - 2.1. Biznes dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, me kuotë 200 studentë për vit akademik.
3. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji Universum dega në Ferizaj, rilicencohet për periudhën trevjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), sipas vendimit të AKA/s me nr. 718/25, datë 20.06.2025, për programin e studimeve;
 - 3.1. Teknik Dentar, BP 180 ECTS (R) me kuotë 25 studentë për vit akademik

4. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji Universum dega në Ferizaj, rilicencohet për periudhën trevjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028) sipas vendimit të AKA/s me nr. 587/25, datë 27.05.2025, për programin e studimeve:

4.1. Biznes dhe Menaxhment, BA, 180 ECTS, me kuotë 150 studentë për vit akademik.

5. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji Universum dega në Ferizaj, rilicencohet për periudhën pesëvjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030) për programin e studimeve:

5.1. Dizajn i Modës, BA 180 ECTS me kuotë 75 studentë për vit akademik

3. Bartësi privat i arsimit të lartë/ Kolegji Universum, sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim ose tejkalim të këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka shqyrtuar kërkesën me nr. 5-3540 të datës 22.09.2025 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji Universum dhe vendimeve të Agjencionit të Kosovës për Akreditim me nr. 588/25 datë: 27.05.2025, vendimit nr. 718/25 datë: 20.06.2025 si dhe vendimit nr. 587/25 datë: 27.04.2025.

Licenca si dhe rilicenca e Kolegjit Universum zgjat sipas dispozitivit të këtij vendimi për programet e studimeve duke u bazuar në vendimet e nxjerra nga AKA.

Komisioni për Licencim dhe rilicencim në MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin për aplikim, kërkon nga Kolegji Universum në Lipjan, brenda vitit kalendarik deri më 01 shtator 2026 të ofroj lejen e legalizimit dhe vendimin për ndryshim të destinacionit nga ai afarist në veprimtari arsimore nga organi kompetent, Drejtoria e Urbanizmit-Komuna e Lipjanit.

Nëse brenda vitit kalendarik nuk dorëzohet leja e legalizimit të objektit dhe vendimin për ndryshimin e destinacionit brenda datës 01.09.2026, Kolegjit Universum në Lipjan, nuk i lejohet regjistrimi i studentëve për vitin akademik 2026/2027.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit Universum;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. DALSH;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.

Kryetar i Komisionit



Burim Gashi